

VENDIM
Nr.157, datë 18.3.2004

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.424, DATË 9.7.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE
QË KRIJOJNË INSTITUCIONET BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave të bëhet kjo shtesë:

-Në shkronjën “a” të pikës 1 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria kryesore dhe nga shitja e biletave të Teatrit Kombëtar, Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit, Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore dhe Teatrit Kombëtar për Fëmijë, institucione këto kombëtare, buxhetore të kulturës dhe të artit, në varësi të Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, t’u mbeten këtyre institucioneve, në masën 90 për qind, ndërsa 10 për qind të derdhen në Buxhetin e Shtetit.”.

2. Ngarkohen Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministri i Financave për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët për përdorimin e këtyre të ardhurave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano